



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



**Prishtinë, 16.11.2022**  
**Kodi i ZRRE-së:V\_1612\_2022**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: ZRRE/DMK\_V\_2340\_07\_22 i dt.27.07.2022;
- Ankesa e konsumatorit e datës 28.09.2022.

**në seancën e mbajtur më datë 16.11.2022 nxori këtë:**

**V E N D I M**

- I. REFUZOHET** ankesa e konsumatorit Nexhmije Xhemajli(Qebaptore) nga Komuna e Prishtinës.
- II. MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRRE/DMK\_V\_2340\_07\_22 i dt.27.07.2022.

**A r s y e t i m**

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 27.07.2022 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK\_V\_2340\_07\_22 me të cilin e ka refuzuar ankesën e konsumatorit, me të cilën ankesë e ka kontestuar përgjigjën e KESCO-s – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 13.05.2022 lidhur me kontestimin e faturës së periudhës shkurt 2022 për shkak të dyshimit në leximin dhe faturimin jo të saktë me njehsorin elektrik nr. 78476643.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, pala Nexhmije Xhemajli(parashtruesi: Qendrim Sadiku) , brenda afatit ligjor ka paraqitur Ankesë në Bordin e ZRRE-së, për këto shkaqe:

- Kundërshton vendimin e DMK-së dhe konstaton se i njëjti është i padrejtë;
- Pretendon se faturimi i periudhës shkurt nuk mund të jetë real duke u bazuar në konsumin e me hershem;
- Pala kërkon nga Bordi që të shqyrtoj ankesën në kohë dhe të merr vendim të drejtë.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 16.11.2022 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin se faturimi nr. 02220DPR-90036903 datë 24.02.2022 me njehsorin elektrik nr. 78476643 nuk është i saktë, Bordi pas shqyrtimit të të gjitha provave dhe shkresave si: Procesverbalin e inspektimit nr. 2001527 datë 10.05.2022; faturën nr. 02220DPR-90036903 datë



24.02.2022; Ankesa e konsumatorit në KESCO datë 02.04.2022; Përgjigja e KESCO-s datë 13.05.2022; Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së datë 01.06.2022; Vendimi i DMK-së ZRRE/DMK\_V\_2340\_07\_22 i dt.27.07.2022, Transaksionet e konsumatorit; Rrjedha e energjisë elektrike gjeti se faturimi i periudhës shkurt është real. Kështu KESCO ka vepruar konform Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, andaj nuk ka dyshime që vendimi i marrë nga DMK-ja është vendim i drejtë dhe i ligjshëm.

Në shqyrtim e sipër të rastit, ZRrE ka vërejtur se, pas ankesës së konsumatorit, me datë 10.05.2022 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 78476643 ku TL=6554 kWh dhe TU=2185 kWh. Ekipi i KEDS-it po ashtu ka evidentuar të dhënat teknike të pikës matëse si dhe ka evidentuar që njehsori nga jashtë duket në rregull si dhe kontrollohen hyrjet daljet janë në rregull. Bazuar në të dhënat e evidentuara në procesverbal vërtetohet se shpenzimet e konsumatorit të evidentuara dhe faturuara në CCP për periudhën prill 2022 përputhen me shpenzimet e evidentuara në procesverbalin e inspektimit.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e datës 12.10.2022 ka kërkuar që të behet ndërrimi i njehsorit elektrik nr.78476643 dhe i njëjti të dërgohet për shqyrtim të saktësisë së matjes. Me datë 13.10.2022 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për ndërrim njehsori kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 78476643 me gjendje TL=7281 kWh dhe TU=2434 kWh si dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 87406677 me gjendje TL=000118 kWh dhe TU=000092 kWh. Me datë 18.10.2022 punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë shqyrtimin e saktësisë së matjes për njehsorin elektrik nr. 78476643 me gjendje TL=7284 kWh dhe TU=2434 kWh ku kanë konstatuar se: njehsori elektrik është në rregull, njehsori elektrik nuk ka probleme me sisteme matëse, njehsori elektrik blloibat(vulat) i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsori dëmtime nuk ka si dhe gabimi në matje është +0.53% e që kjo është brenda kufijve të lejuar të gabimit të përcaktuar me Kodin e Matjes së OSSH.

Bordi, ka analizuar rrjedhën e energjisë elektrike si dhe listat e leximit dhe konstaton se lexuesi i KEDS-it ka bërë inspektim dhe lexime të rregullta mujore dhe se në asnjë rast nuk ka evidentuar që nuk ka qasje në leximin e njehsorit elektrik por që në periudhën 02/2022 ka evidentuar se leximi behet në mënyrë manuale. Sipas analizës së rrjedhës së energjisë elektrike për periudhën kontestuese si dhe të më hershme, konstatohet se konsumatori ka ndryshim në shpenzimet e energjisë elektrike por që edhe përkundër faktit që është bërë shpërndarjen e kWh të faturuara për periudhën dy mujore 01/2022-02/2022 konstatohet se konsumatorit nuk i takon korrigjim financiar.

Bazuar në të gjitha analizat e bëra konstatohet se KESCO ka vepruar konform nenit 28 paragrafit 1, dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: 1. *Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar r dhe për tarifën tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme) dhe 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit univerzal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit”.*

Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i



bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 16.11.2022 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, përfshi edhe procesverbalin mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr.0207446 datë 13.10.2022 si dhe procesverbalin e shqyrtimit të saktësisë së matjes të njehsorit elektrik Nr.org.02Nr. 13592 datë 18.10.2022 ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.


IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.


Bordi i ZRRE-së:

  
Ymer Fejzullahu, Kryesues

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Rushiti, anëtar

  
Lutfiye Dervishi, anëtare

  
Gani Bucaj, anëtar

**Vendimi u dërgohet:**

- KESCO-s,
- Konsumatorit Nexhmije Xhemajli dhe
- Arkivit të ZRRE-së.